



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-096

Prishtinë, më 4 nëntor 2024, ora 11:19
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 4 NËNTOR 2024

Në mbledhje morën pjesë: Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Saranda Bogujevci, Kujtim Shala dhe Bahrim Shabani, nënkryetarë të Kuvendit.
Mungoi: Enver Hoxhaj, nënkryetar i Kuvendit.

Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë: Mimoza Kusari-Lila, Abelard Tahiri, Arben Gashi dhe Besnik Tahiri.
Mungoi: Enis Kervan, kryetar i GP Multietnik.

Në mbledhje mori pjesë edhe zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, Arben Loshi.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Stafii përgjegjës i Administratës së Kuvendit për mbështetje Kryesisë së Kuvendit, si dhe nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit, nga grupet parlamentare dhe nga organizatat.

Mbledhjen e kryesoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Me propozim të kryetarit, Kryesia e plotësoi rendin e ditës me dy (2) pika për shqyrtim nga Kryesia e Kuvendit.

Pastaj, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Seanca plenare, e shtyrë nga data e paraparë që të mbahet më 24 maj 2024,
3. Vazhdimi i seancës së jashtëzakonshme, e filluar më 16 tetor 2024,
4. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
5. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 28 tetor 2024

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 28 tetor 2024.

2. Seanca plenare, e shtyrë nga data e paraparë që të mbahet më 24 maj 2024

3. Vazhdimi i seancës së jashtëzakonshme, e filluar më 16 tetor 2024

Kryetari nuk vendosi për datat e mbajtjes, përkatësisht për vazhdimin e seancave të lartshënuara nga pikat 1 dhe 2.

* * *

Por, kryetari, me propozim të kryetares së GP të LVV-së, Mimoza Kusari-Lila, pas diskutimeve, me konsensus, vendosi që seanca e re plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbahet të hënën, më 11 nëntor 2024, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025.

4. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës

Kryetari me konsensus nuk vendosi për caktimin e seancës plenare, me 18 pikat e propozuara të rendit të ditës.

Në vazhdim, kryetari e shtroi çështjen e procedimit të Nismës legjislative të qytetarëve për hartimin e Projektligjit për parandalim të vetëvrasjes, e cila ishte në rend dite në seancën plenare më 31 tetor 2024, por që është hequr nga ai rend dite.

Në lidhje me procedimin e nismës së lartshënuar legjislative diskutuan: nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci, kryetari i GP të AAK-së, Besnik Tahiri, dhe kryetari i GP të LDK-së, Arben Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve të lartshënuara, Kryesia vendosi që nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci, t'i takojë përfaqësuesit e nismës legjislative të qytetarëve për të diskutuar në lidhje me procedimin e nismës legjislative, e më pas të njoftohet Kryesia e Kuvendit.

5. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

1. Kërkesa për publikimin e konkursit për dhjetë (10) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe për sigurimin e buxhetit

Kryesia, pas diskutimeve në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Të shpallet konkursi publik për dhjetë (10) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (prej tyre së paku tre (3) anëtarë duhet të jenë nga radhët e komuniteteve joshqiptare dhe së paku dy (2) anëtarë duhet të jenë të gjinisë femërore).
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që në bazë të dispozitave të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 08/L-180, ta publikojë konkursin publik nga pika një (1) e këtij vendimi.
2. *Kërkesa e deputetit Pal Lekaj për lejimin e udhëtimit zyrtar në Belgjikë*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Pal Lekaj, i lejohet udhëtimi zyrtar në Bruksel (Belgjikë), prej datës 3 deri më 5 dhjetor 2024.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të regjistrimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarin në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. *Kërkesa e deputetes Rrezarta Krasniqi për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës*

Kryesia, me propozim të kryetarit të GP të LDK-së, Arben Gashi, e shtyu shqyrtimin e kërkesës së lartshënuar, me qëllim që GP i LDK-së të përcaktohet se cili deputet nga ky grup parlamentar do të marrë pjesë në Forumin Parlamentar për Inteligjencë dhe Siguri, nga data 2 deri më 6 dhjetor 2024.

4. *Kërkesa e deputetes Fjolla Ujkani për mbulimin e shpenzimeve të biletës së kthimit nga udhëtimi zyrtar*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Fjolla Ujkani, i mbulohet shpenzimi në shumën prej 405,00 euro për biletën e kthimit Budapest - Prishtinë, më 29. 10. 2024, nga udhëtimi zyrtar, i realizuar në Budapest (Hungari), nga data 27 deri më 29 tetor 2024.

5. *Kërkesa e nëpunëses së Administratës së Kuvendit të Kosovës, Hajrije Hajredinaj, për mbështetje financiare*

Kryesia nuk vendosi për kërkesën e lartshënuar, në mungesë të një raporti për dëmet e shkaktuara, për të cilat është kërkuar mbështetja financiare.

6. Kërkesa e deputetes-kryetares së Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm, Fatmire Kollçaku, për mbulimin e shpenzimeve të Konferencës Rajonale

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Mbulohen shpenzimet në shumën prej 250,00 euro të Konferencës Rajonale të Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm, që do të organizohet në Prishtinë, prej datës 11 deri më 12 nëntor 2024, sipas kërkesë nr. 08/5568/Do-2596/2, datë 4. 11. 2024.

7. Kërkesa e deputetëve Mimoza Kusari-Lila, Armend Muja dhe Hykmete Bajrami për mbulimin e tejkalimit të shpenzimeve në udhëtimin zyrtar në SHBA

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës: Mimoza Kusari-Lila, Armend Muja dhe Hykmete Bajrami, u mbulohen tejkalimet e shpenzimeve të akomodimit, përfshirë edhe tejkalimin e deputetes Hykmete Bajrami për një natë në Stamboll, në udhëtimin zyrtar të realizuar në Uashington D.C (Shtete të Bashkuara të Amerikës), prej datës 21 deri më 26 tetor 2024, sipas kërkesës nr. 08/5569/Do-2598, datë 4. 11. 2024.

* * *

Gjithashtu, në fund, Kryesia në lidhje me pjesëmarrjen në Forumin Parlamentar për Inteligjencë dhe Siguri, mori këtë:

V E N D I M

1. Kryetares së Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Ganimete Musliu, i lejohet udhëtimi zyrtar në Uashington D.C. (Shtete të Bashkuara të Amerikës), prej datës 2 deri më 6 dhjetor 2024.

2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarën në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryetari e mbylli mbledhjen në orën 11:43 minuta.

Glauk Konjufca

Kryetar i Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale